

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë e shkallës së parë, gjyqtari Naim Kurtishi, me bashkëpunëtorin profesional, Shahadin Destani, në çëshjen juridike kontastimore të paditësit E. K., nga Prizreni, me banim në rrugën “.....”, nr. /./ , të cilin me autorizim e përfaqëson av. P. P. , nga Prizreni, kundër të paditurit Y. E. , nga fshati ... , Komuna e Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i dëmit jomaterial, vlera e kontestit 3,500.00 € pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt.13.03.2014 morri këtë

A K T G J Y K I M

- I. PJESËRISHT APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit E. K. , nga Prizreni.
- II. OBLIGOHET** i padituri Y. E., nga fshati ... , Komuna e Prizrenit, që për shkaktimin e frikës me datë 12.09.2011, tani paditësit në emër të dëmit jo material ti kompensoj shumën prej 2,500.00 (dymijë e pesëqind) euro me kamat ligjore në lartësi që paguan banka për afatizimin e mjeteve në bankë mbi një vit, duke filluar nga data 24.09.2012, deri në pagesën përfundimtarë, si dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të kësaj procedure, paditësit të ia paguaj shumën prej 650.00 euro, të gjitha këto brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën ekzekutim të përmbarimit ligjor.
- III.** Pjesa e kërkesëpadisë mbi aprovimin, refuzohet si e pabazuar

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi në të dhënat e padisë së shkruar dhe të dhënat nga shqyrtimi përgatitor, dhe i njëjti në fjalën përfundimtare ka deklaruar se përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit jo material, është vërtetuar nga rrethanat që dalin nga aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.298/11 të datës 30.08.2012, si dhe nga dëshmia e paditësit e deponuar në gjatë shqyrtimit kryesor, po ashtu në mendimin e ekspertit të neuropsikiatrisë dr. N. F. , është vërtetuar shkalla edhe koha e përjetimit të frikës për shkak të veprimeve të të paditurit. Ai gjithashtu ka theksuar se në anën e të paditurit ekziston përgjegjësia për dëmin jo material e bazuar në intensitetin dhe kohën e vërtetuar të ekzistimit të frikës andaj konsiderojmë se lartësia e kërkesëpadisë është e bazuar. Duke u bazuar nga të gjitha të cekurat më lartë i ka propozuar gjykatës që të aprovoi në tërësi kërkesëpadinë, njëkohësisht ka kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve në shumë prej 540 euro për katër seanca nga 135 euro sipas TA-së së aplikueshme si dhe shumën prej 100 euro për angazhimin e ekspertit, dr. N. F. .

I padituri në përgjigjen në padi me shkrim ka mohuar në përgjithësi të gjitha faktet e parashtruara në padi po ashtu e ka mohuar në tërësi edhe kërkesëpadinë. Ai gjithashtu ka kontestuar faktin që paditësit ti ketë shkaktuar aq frikë dhe ankthe sa është paraqitur në padi me arsyetimin se nuk ka pasur për qëllim që ta lëndoj ose ti shkaktoj ndonjë të keqe E. E. – këtu paditësit. Ai gjithashtu edhe gjatë shqyrtimit përgatitor ka deklaruar se vërtet me datë 12.09.2011 tani paditësi duke e drejtuar automjetin e rëndë të firmës Bektelenka nuk i është përmbajtur kërkesës time për të mos hyrë në arën time i njëjti ka dëmtuar shiritin kufizues dhe ka hyrë në këtë arë. Unë i revoltuar nga këto veprimeme pushkën time AK-47 kam gjuajtur në gomat e perparme të kamionit, atëherë i njëjti është ndalur ndërsa unë nuk kamë përdorur kurrfarë force e as që e kamë rrezikuar me këtë automatik vetë personalitetin e paditësit E. K. , andaj i ka propozuar gjykatës refuzimin e kërkesëpadisë si të pazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë leximin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.298/11 të datës 30.08.2012, bëri leximin nga deponimi i deklaratës së paditësit në cilësinë e dëshmitarit E. K. , bëri leximin e raportit të ekspertizës mjeko – ligjore psikiatrike të dr. N. F. i datës 27.01.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha atë së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Me leximin e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P.nr.298/11 të datës 30.08.2012, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Y. E. , për veprimet e tija të cilat janë shkak për shkaktimin e frikës që është edhe objekt i kësaj padie, është shpallur fajtor dhe është dënuar.

Nga deklarata e paditësit E. K. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor në cilësinë e dëshmitarit gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri me veprimet e tija ka shkaktuar frikë paditësit.

Me leximin e raportit të ekspertizës mjeko – ligjore psikiatrike dhe mendimit të dhënë nga dr. N. F. me datës 27.01.2014, është konstatuar se paditësi ka pasur *frikë primare* që ka zgjatur 5 minuta e karakterizuar me një vërshim intenziv emocional për mundësinë e vdekjes, gjithashtu paditësi E. K. ka pësuar *frikë sekondare* të intensitetit të lartë - një javë, e manifestuar si shqetësim intenziv nga rasti si dhe një frikë që shpërthente sa herë përkujtonte mundësinë e përfundimeve fatale për vetveten në incident.

Andaj gjykata duke u bazuar në provat e lartcekura vërteton faktin se i padituri i ka shkaktuar frikë të intensitetit të lart dhe të mesëm paditësit me veprimet e tija me kryerjen e veprës penale në shumë prej 2,500.00 €.

Me nenin 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) – i aplikueshëm në kohën e paraqitjes së padisë Ligji nr. 3/3/1978, është paraparë se *“për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës, të prishjes, të shkëljes së nderit ose lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën, gjykata po të konstatoj rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë, do të gjykoj kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është konform nenit 452.1 të LPK-së, ku janë llogaritur shpenzimet për përpilimin e padisë, taksat gjyqësore, për përfaqësime, për angazhimin e ekspertit, sipas TA-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 200 të LMD-së nr. 3/3/1978, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.865/12, datë 13.03.2014

Bashkëpunëtori profesional
Shahadin Destani

Gjyqtari
Naim Kurtishi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.